

KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

V.1 SISTEMI I PAGESAVE

- Objektivat e sistemit

Një nga detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë (mbështetur në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”) është nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të një sistemi pagesash të sigurt dhe eficient.

Në drejtim të stimulimit të funksionimit normal të sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë është e përfshirë jo vetëm në hartimin dhe reformimin e kuadrit rregullator e procedural për sistemin dhe instrumentet e pagesave, por edhe në mbikëqyrjen e operacioneve, duke qenë njëkohësisht dhe i vetmi institucion që organizon dhe lehtëson shlyerjen e pagesave dhe të letrave me vlerë në vend.

Synimi i Bankës së Shqipërisë ka qenë dhe mbetet ndërtimi i një sistemi pagesash në përputhje me 10 Parimet Themelore për sistemet e rëndësishme të pagesave, të përcaktuara nga BIS/CPSS.

- Komunikimi dhe Transparenca

Një nga përgjegjësitë e Bankës së Shqipërisë si bankë qendrore, në përputhje me parimet themelore për sistemet e rëndësishme të pagesave, është të mbikëqyrë sistemin në mënyrë efektive, të përgjegjshme dhe transparente.

Për të bashkërenduar punën e të gjithë pjesëmarrësve në sistem, Banka e Shqipërisë ka krijuar një forum ndërbankar të përhershëm, Komitetin Kombëtar të Pagesave. Ky Komitet mblidhet rregullisht për t’u konsultuar, si edhe për të miratuar marrëveshje ndërbankare, që kanë për qëllim mirëfunksionimin e sistemit të pagesave në Shqipëri. Si pjesë e mekanizmit të konsultimit, përfaqësues nga bankat e nivelit të dytë ftohen rregullisht (janë krijuar komitete koordinatorësh për projektet në proces) për të paraqitur sugjerimet e tyre për përmirësimin e sistemit.

Banka e Shqipërisë publikon në mënyrë të vazhdueshme informacione mbi zhvillimet në sistemin e pagesave, mbi kuadrin rregullator përkatës, si dhe është e angazhuar në fushatën mbarëkombëtare të kanalizimit të parasë – cash në sistemin bankar.

V.1.1 ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

- Sistemi Shqiptar i Pagesave Ndërbankare – AIPS

Në vijim të një pune të kujdesshme dhe intensive gjatë vitit 2003, muaji janar 2004 shënoi fillimin e operacioneve të Sistemit Shqiptar të Pagesave

Ndërbankare (AIPS – Albanian Interbank Payment System). Ky ishte një projekt i rëndësishëm, dhe u konsiderua si infrastruktura kryesore lidhëse e thuajse të gjithë sistemit bankar. Sistemi është realizuar në përputhje me standardet dhe me parimet më të mira ndërkombëtare, duke u bazuar në teknologji moderne e bashkëkohore. Projekti u realizua nën asistencën dhe konsulencën e Bankës Botërore.


Sistemi AIPS synon:

- i) përmirësimin e sigurisë dhe të eficiencës në sistemin bankar, duke bërë të mundur shkëmbimin dhe shlyerjen e shpejtë dhe elektronike të pagesave me vlerë të madhe mes bankave;
- ii) ofrimin, Bankës së Shqipërisë, të një mjeti eficient të administrimit të rrezikut sistematik; dhe
- iii) krijimin e një platforme të përshtatshme teknike dhe operacionale për zhvillimin e mëtejshëm në sistemin e pagesave dhe në sistemet e lidhura financiare.

Pjesëmarrëse në sistem janë të gjitha bankat e nivelit të dytë (Banka Dardania është pjesëmarrëse indirekte) dhe Banka e Shqipërisë. Kjo e fundit është në rolin e pronarit të sistemit si edhe mbikëqyr, organizon, administron dhe operon sistemin.

Sistemi AIPS ekzekuton shlyerjen bruto e në kohë reale të të gjitha pagesave me vlerë të madhe (ndryshe të kategorizuara si pagesa me rëndësi sistematike, aktualisht me vlerë mbi 1 milion lekë) brenda territorit të Shqipërisë, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar (bankat kanë mundësinë e vendosjes dhe të administrimit të prioriteteve për pagesat e tyre). Sistemi u mundëson pjesëmarrësve në të monitorimin dhe administrimin më të mirë të likuiditeteve të tyre (sistemi siguron informacion në kohë reale për gjendjen e llogarisë, rezervave të lira, pagesat në pritje për t’u ekzekutuar). Gjithashtu, sistemi AIPS krijon mundësinë e kreditimit nga Banka e Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë, me qëllim plotësimin e nevojave të bankave për likuiditet brenda ditës dhe garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit të sistemit, në përputhje me vendimet dhe me objektivat e miratuara të politikës monetare.

Grafik V.1 Shpërndarja e transaksioneve sipas AIPS.



Baza ligjore për funksionimin e sistemit përbëhet nga rregullorja për “Rregulla dhe Procedura të Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare – AIPS” miratuar me vendimin nr. 103, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës, Kontrata e Pjesëmarrjes në Sistem, si dhe rregullat e procedurat për çdo pjesëmarrës në sistem. Gjithashtu, gjatë vitit 2004, me vendimin nr. 20, datë 24.03.2004 u miratua rregullorja “Mbi kredinë brenda ditës”, mbi të cilën u bazuan dhe marrëveshjet përkatëse ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë.

Gjatë vitit 2004, nëpërmjet sistemit AIPS u qarkullua një vëllim prej 2,176 miliardë lekësh, ku afërsisht 58 për qind përbëhej nga veprime të iniciuara nga Banka e Shqipërisë, 25 për qind nga veprimet e letrave me vlerë, ndërsa 17 për qind nga veprimet ndërbankare dhe për klientelën.

Veprimet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë përbëhen kryesisht nga operacionet monetare (veprimet valutore, investime në letrat me vlerë, kredi dhe depozita – 72 për qind), veprime me cash-in (Banka e Shqipërisë furnizon me cash degët e saj si dhe bankat e nivelit të dytë – 14 për qind) dhe buxheti i shtetit (veprimet e kryera me llogarinë e buxhetit të shtetit – 14 për qind).


	Numër	Vlerë ()
Banka e Shqipërisë*	15,143	1,254.10
Letra me vlerë të Qeverisë (ankandet)	216	559.21
Pagesa ndërbankare	5,075	276.15
Pagesa për klientët bruto (U.P. mbi 1 milion lekë)	7,407	63.53
Kleringu net (U.P. deri 1 milion Lekë + Çequet)	739	23.44
Totali	28,580	2,176.42

Tabelë V.1. Shpërndarja e veprimeve në numër dhe në vlerë (në miliardë lekë).

- Shërbimi i kleringut

Nëpërmjet kleringut (Banka e Shqipërisë e ka ofruar si shërbim që në vitin 1997), ofrohet përpunimi dhe klerimi i instruksioneve të pagesave me vlerë të vogël dhe të instrumenteve letër të iniciuara nga klientët e bankave.

Banka e Shqipërisë mundëson shlyerjen me bazë neto të të gjitha pagesave me vlerë të vogël, të kanalizuar në sistem nga bankat në mbyllje të seancës së kleringut. Që nga viti 1999 shumica e urdhërpagesave kalojnë në klering nëpërmjet rrjetit të SWIFT-it, ndërsa klerimi i çeqeve realizohet nëpërmjet shkëmbimit fizik të tyre në seancat e kleringut, që zhvillohen çdo ditë pranë Bankës së Shqipërisë. Ekzekutimi i këtyre instruksioneve të shlyerjes neto kryhet në sistemin AIPS.



Gjatë vitit 2004, sistemi i kleringut kanalizoi pagesat me vlerë deri në 1 milion lekë (urdhërpagesat me vlerë më të madhe kalojnë direkt në sistemin AIPS ku shlyhen bruto). Instrumenti më shumë i përdorur gjatë vitit 2004 ishte urdhërpagesa, me 89 për qind të vëllimit të pagesave dhe gati 76 për qind të vlerës së pagesave për klientët. Përdorimi i çekut si instrument pagese vazhdon të mbetet në nivele modeste. Tipi më i përdorur është çeku bankar.

Vlerë (miliardë lekë)	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Urdhërpagesa	22.50	25.60	28.00	32.90	40.90		67.16*
Çeqe	15.50	24.40	26.30	28.90	31.80		21.40


Tabelë V.2. Përdorimi i çekut dhe urdhërpagesës.

- Mjetet elektronike

Viti 2004 shënoi një hap tjetër në përpjekjet e sistemit bankar për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së pagesave, duke investuar më tej në drejtim të përdorimit të mjeteve elektronike të pagesave.

Numri i terminaleve pranuese ka ardhur duke u rritur, trend më i dukshëm ky në gjysmën e dytë të vitit 2004. Në fund të vitit 2004 numri i ATM-ve ishte 93, kurse i POS/EFTPOS-eve 155, kundrejt 22 dhe 53 respektivisht për fundvitin 2003. Sipas raportimeve të bankave pranë Bankës së Shqipërisë, pajisjet pranuese të kartave (ATM dhe POS) operojnë kryesisht në Lekë.

Grafik V.3. Ecuria e sistemeve elektronike të pagesave.



Vetëm gjatë vitit 2004, numri i kartave (cash-i, debiti dhe krediti) në përdorim u rrit me rreth 3.7 herë (në dhjetor 2004 numëroheshin 34,094 karta). Kartat janë lëshuar kryesisht në lekë, ndërsa lloji më shumë i përdorur është karta me funksion cash-i. Thëksojmë se me zhvillimet e fundit në shërbimet e ofruara dhe me zgjerimin e rrjetit të pajisjeve pranuese të kartave, bankat po i përshtatin kartat e tyre me funksion cash-i në karta me funksion debitimi. Kështu, e njëjta kartë mund të përdoret lehtësisht si në ATM-të e bankës ashtu edhe në çdo pikë (POS/EFTPOS) ku pranohet ajo kartë. Gjithashtu, pjesa më e madhe e kartave të lëshuara funksionojnë për momentin si një monedhë – një kartë, kurse vetëm një numër i vogël kartash e lejojnë përdoruesin e tyre të ketë akses në më shumë se një monedhë.

V.1.1 PROJEKTET E ARDHSHE MBI SISTEMIN E PAGESAVE

- Projekti - Sistemi i Kryqëzimit të Pagesave me Vlerë të Vogël – AECH

Në linjë me objektivin e zhvillimit të një sistemi të besueshëm, të sigurt dhe të integruar pagesash dhe klerimi, hapi i dytë i ndërmarrë gjatë vitit 2004 nga Banka e Shqipërisë ishte fillimi i zbatimit të projektit për kryqëzimin e pagesave me vlerë të vogël (AECH – Albanian Electronic Clearing House). Ky sistem, që do të mbështetet dhe integrohet tek ai AIPS, do të mundësojë automatizimin e shërbimit të kleringut që ofrohet aktualisht nga Banka e Shqipërisë për përpunimin e pagesave me vlerë të vogël. Ky projekt realizohet nën asistencën dhe konsulencën e Bankës Botërore. Pritet që vënia në përdorim e sistemit AECH (parashikohet në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2005) të sjellë përfitime të ndjeshme në sistemin e pagesave në drejtim të automatizimit të proceseve e njëkohësisht rritjes së saktësisë, shpejtësisë dhe uljes së kostove të përpunimit.

Sistemi AECH mundëson shlyerjen me bazë neto të të gjitha pagesave me vlerë të vogël, të kanalizuar në mënyrë elektronike në sistem nga bankat

(pjesëmarrja është e ngjashme me AIPS), në orare të përcaktuara (në mbyllje të seancës/ave së kleringut). Ekzekutimi i këtyre instruksioneve të shlyerjes neto do të kryhet në mënyrë të parevokueshme në sistemin AIPS. Bankat kanë mundësi të monitorojnë dhe të administrojnë radhën e pagesave në grup si dhe likuiditetet e tyre.

- Projekti - për Klerimin e Kartave

Në vijim të objektivave të saj për rritjen e qarkullimit të parasë nëpërmjet sistemit bankar, dhe në rolin e saj si promovuese e prezantimit të instrumenteve të reja e zhvillimit të infrastrukturave të nevojshme për modernizimin e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë, ka në projektet e saj krijimin e një sistemi për klerimin e kartave elektronike. Synimi kryesor është lehtësimi i përdorimit të kartave elektronike nga klientët, si dhe klerimi i veprimeve të kryera në monedhën vendase.

V.2 INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

V.2.1 INTEGRIMI EVROPIAN

Bisedimet zyrtare për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, vazhduan edhe gjatë vitit 2004. Banka e Shqipërisë ka qenë një pjesëmarrëse aktive në grupin negociator të Qeverisë Shqiptare, i cili bashkërendon punën e institucioneve përkatëse në procesin e negocimit të marrëveshjes me Bashkimin Evropian.

Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga procesi i stabilizim-asociimit, Banka e Shqipërisë ka qenë dhe vazhdon të jetë në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimit Evropian, në lidhje me hartimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit duke u përqendruar në çështjet që kanë të bëjnë me kapitullin 4 (lëvizja e lirë e kapitalit) dhe kapitullin 11 (bashkimi ekonomik dhe financiar) të legjislacionit evropian.

Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë ka përgatitur versionin paraprak të matricës për liberalizimin e llogarisë kapitale. Hartimi i kësaj matrice është bërë duke u bazuar në detyrimet që rrjedhin nga draft-Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit si dhe është përfituar nga përvoja e vendeve të rajonit që kanë qenë të angazhuara në të njëjtin proces. Vlerësimet e para nga Drejtoria e Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Komisionit Evropian kanë qenë pozitive.

Synimi strategjik i Bankës së Shqipërisë është përafrimi institucional, organizativ dhe operacional me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore dhe më konkretisht, me Bankën Qendrore Evropiane. Për këtë qëllim, një nga pikat e Protokollit të Bashkëpunimit Ekonomik të Shqipërisë me Republikën Federale të Gjermanisë parashikon dhënien e asistencës për përafrimin me Bankën Qendrore Evropiane. Gjatë vitit 2004, në bashkëpunim me GTZ-në